

V E N D I M
Nr.26, datë 15.4.2002

**PËR DISA NDRYSHIME E PLOTËSIME NË VENDIMIN NR.3, DATË 17.9.2001 “PËR
KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT DHE PËRBËRJEN E KRYESIVE TË
TYRE”, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.17, DATË 14.2.2002**

Në mbështetje të neneve 23, 24, 27 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, si dhe duke u mbështetur në marrëveshjen e kryesive të grupeve parlamentare,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.3, datë 17.9.2001 “Për komisionet e përherëshme të Kuvendit dhe përbërjen e kryesive të tyre”, ndryshuar me vendimin nr.17, datë 14.2.2002, bëhen këto ndryshime dhe plotësime:

1. Komisioni i Përherëshëm për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore të bëhet nga 13 në 15 anëtarë, ku të bëjë pjesë deputeti Mustafa Muçi në vend të deputetit Fatmir Xhafa, si dhe të shtohen deputetët Bashkim Fino dhe Fatmir Mediu.
2. Komisioni i Përherëshëm për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin të bëhet nga 13 në 15 anëtarë. Në këtë komision të bëjnë pjesë edhe deputetët Anastas Angjeli e Arben Imami.
3. Në Komisionin e Përherëshëm të Rendit dhe SHISH-it të bëjë pjesë deputeti Ben Blushi në vend të deputetit Marko Bello.
4. Në Komisionin e Përherëshëm të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit të bëjë pjesë deputeti Gjergj Koja në vend të deputetit Mustafa Xhani.
5. Në Komisionin e Përherëshëm për Politikën e Jashtme të bëjnë pjesë deputetët Paskal Milo, Ilir Gjoni dhe Ilir Meta në vend të deputetëve Kastriot Islami, Marko Bello dhe Mustafa Xhani.
6. Në Komisionin e Përherëshëm për Industrinë, Punët Publike dhe Tregtinë të bëjë pjesë deputeti Dritan Prifti në vend të deputetit Viktor Doda.
7. Në Komisionin e Përherëshëm të Arsimit, Kulturës, Shkencës e Sporteve të bëjë pjesë deputeti Shpëtim Kateshi në vend të deputetit Agron Tato.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Namik Dokle